

---

**Lënda:** Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objektëve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2012 deri në vitin 2018.

**Objekti:** Rikonstruksion i Rrugës Ali Shefqëti, Tiranë

**Investitori:** Bashkia Tiranë

**Vlera e Investimit:** 60,677,499 lekë

**Periudha kohore:** Korrik 2015 deri në Mars 2017

**Inspektimi është kryer:** Dhjetor 2018

Ky objekt zbatohet në qytetin e Tiranës në një nga segmentët kryesore të tij. Segmenti rrugor nis nga bashkimi i "Rrugës Ali Shefqeti" me Lumin e lanës së Tiranës dhe përfundon në fundin e këtij segmenti rrugor, në bashkimin me rrugën "Bashkim Kodra", pranë zonës së banesave sociale ndërtuar nga Bashkia Tiranë, me një gjatësi të përgjithshme rreth 1,4 km. Gjendja ekzistuese e rrugës ka qenë e amortizuar.

Projekti ka ndërhyrë në rehabilitimin e shtresave rrugore të trupit të rrugës (shtrimi me binder dhe shtrimin me asfalt), në rehabilitimin e plotë të shtresave të dëmtuara të trupit të rrugës me të gjitha komponentët e saj, në rehabilitimin e rrjetin të ujrave të bardha, me sistemimin e të gjitha pusetave të ujrave të zeza, në sistemimin e trotuareve, në rehabilitimin e rrjetin të ndriçimit, në sinjalistike rrugore, etj. Projekt zbatimit ka parashikuar një rikonstruksion të përgjithshëm të këtij segmenti rrugor.

Punimet kanë filluar në Korrik të vitit 2015, ndërkohë që është bërë inagurimi për përfundimin e saj në muajin Prill 2017 që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Afati i garancisë së punimeve për këtë tipologji ndërtimi është dy vjet. Pra rezulton se akoma nuk ka përfunduar afati kohor i garancisë së punimeve të veprës. Duhet të përmendim se zbatimi i punimeve është bërë në kushte të vështira pasi rruga ka patur trafik të rënduar dhe bllokimi i saj është bërë vetëm me periudha të shkurtra kohore. Edhe pse objekti është pothuajse i sapo përfunduar cilësia e zërave kryesore të punimeve lë për të dëshiruar.

---

**Nga pamja vizuale e objektit konstatojmë se:**

- Trupi i rrugës ka levizje (ulje) dhe plasaritje të shtresave të asfaltit (nuk është bërë sipas standardit të sistemimit të nënshtresave që kanë qenë të demtuara), nështresat e asfaltit janë shumë të vogla duke parë kategorinë dhe rëndësinë e këtij segmenti rrugor;



**Fig. 1**

Ka sipërfaqe të shtresës së asfaltit e cila ka filluar që të thërmohej e të shkeputet (gje që tregon se shtresa asfaltike nuk është material cilësor dhe sipas standarteve)



Fig 2

Vihen re ulje dhe thyerje e plasaritje te pllakave te trotuareve, Trotuaret kryesisht ne fillim te kesaj rruge nuk jane uniforme e ne gjeresi te njetrateshme

Fig 3

Ka puseta te demtuara e vendosura jo ne nivel te njetrajtshem me trupit e rruges (me parete anesore te tyre te demtuar e qe pothuajse te gjitha levizin e jane spostuar)






- Nuk janë respektuar sipas standardit të kërkuar lidhja e trotuareve me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuar (në disa segmente ato pothuajse mungojnë fare);
- Kutitë plastike të shtyllave të ndriçimit janë të thyera e të demtuara;
- Ka patur mosfunksionim të kanaleve të ujrave të bardha gjatë rreshjeve të muajit Dhjetor (edhe për rreshje shiu normale për qytetin);
- Lidhja e trupit kryesor të rrugës me segmentët anësore të saj nuk është bërë uniforme.

Fig 4

Vihen re plasaritje e demtime te kunetave anesore te rruges

Vetëm disa muaj pas përfundimit të inagurimit të saj, edhe pse është ndërhyrë për riparimin e disa defektëve të shfaqura, më rezulton se cilësia e zbatimit të punimeve për këtë objekt, vijon të jetë në kushte jo shumë të kënaqshme (u gërmuan disa segmente ku uljet dhe demtimet janë shumë evidentë).



---

Bashkia Tiranë si Investitore e këtij objekti, ka gjithë detyrimin ligjor për kontrollin e zbatimit të punimeve të ndërtimit. Jam i mendimit se si nga mbikqyrësi i punimeve, por edhe nga Bashkia Tiranë ka patur neglizhencë në kontrollin e zbatimit të punimeve të këtij segmenti rrugor shumë të rëndësishëm, me vlerë investimi të konsiderueshme. Të gjitha këto defektë të shfaqura, firma zbatuese e punimeve do duhej në mënyrë të menjëhershme të nderhynte me fondet e veta për riparimin e menjëhershëm të tyre, pa pritur degradimin e mëtejshëm të saj, apo përfundimin e Garancisë së Punimeve të objektit (fondi garancisë së objektit është 5% e vlerës së situacionit përfundimtar). Gjithashtu Bashkia Tiranë në rolin e Investitorit duhet të evidentojë rigorozisht të gjitha kompanitë që kanë kryer punime zbatimi pranë saj dhe të marrë masa ndaj të gjitha kompanive të cilat kanë ndertuar me cilesi të dobët.

***Konkluzione në lidhje me objektin.***

- *Do duhen të riparohen të gjitha uljet e shtresave të asfaltit në trupin e rrugës.*
- *Të bëhet riparimi i trotuareve duke zëvendësuar të gjitha pllakat prej betoni të parapërgatitura e të thyera në to, si dhe të zëvendësohen të gjitha kutitë plastike të sistemit të ndriçimit rrugor që rezultojnë të dëmtuara.*
- *Të riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuar me lidhje të njëtrajtëshme të tyre me trupin e rrugës e pa pengesa.*
- *Të bëhet riparimi i plotë i të gjitha pusetave të ujrave të bardha e të zeza dhe plotësimi i tyre me kapakët metalike të vendosura në të njëjtën kuotë me trupin e rrugës e të pa lëvizshme.*
- *Të bëhet riparimi i kunetave anësore të rrugës në segmentët e dëmtuara të saj,*
- *Për banoret që kanë ndërtime buzë rrugës kryesore (kryesisht në fillim të saj) të bëhet njoftimi zyrtar i tyre nga Bashkia Tiranë, për të mos lejuar investime të mëtejshme të tyre (flas për ndërtime pa leje), për të mos u përballur në të ardhmen me kosto të shtuar për shpronësimin e tyre nga zgjerimet e mëtejshme të këtij segmenti rrugor,*
- *Sipas mendimit tonë vlera për riparimin e defekteve të vërejtura mendoj se zënë rreth 25 deri 30 % të vlerës së situacionit përfundimtar.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarde të kontratave të zbatimit të punimeve, si dhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr 3, Datë 15.01.2001, Nr 2, datë 13.05.2005 dhe Nr 1, datë 16.06.2011, "Për mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".